



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:000508

Datë: 21.02.2024

Numri i dokumentit: 05354306

CP.nr.1108/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin individual Genc Hasani dhe me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Tahiri, në lëndën përbarimore të kreditorit Xh. G. ndaj debitorit Ndërmarrja “T.” sh.a. lidhur me pagesën e borxhit ne baze te dokumentit përbarimor - Aktgjykimi C.nr. 01/2021, te datës 21.05.2021, i plotfuqishëm me dt.21.07.2021, të lejuar me aktvendim për përbarim CP 1108/21, te datës 09.09.2021, jashtë seance gjyqësore, me datën 21.02.2024 morri ketë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përbarimore e udhëhequr sipas shenjës CP.nr.1108/2021, e iniciuar nga kreditori Xh. G., ndaj debitorit Sh. a “T.”, për shkak të pagesës së tërësishme të borxhit nga debitori.

A r s y e t i m

Kreditori i përbarimit Xh. G. përmes te autorizuarit te tij avokat Gazmend Ismajli me seli ne Mitrovice, ka paraqitur propozim për përbarim në bazë të dokumentit përbarimor – Aktgjykimi C.nr.01/2021, te datës 21.05.2021, i plotfuqishëm me dt. 21.07.2021.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të përbarimit, me aktvendimin C.nr.01/2021, te datës 21.05.2021, i plotfuqishëm me dt.21.07.2021, ka lejuar përbarimin ndaj debitorit Ndërmarrja “T.” Sh. a.

Pasi aktvendimi për ekzekutim CP 1108/21, te datës 09.09.2021, është bere i ekzekutueshëm, banka NLB me dt. ..., me parashtrere ka njoftuar gjykatën se debitori i përmbarimit e ka përmbushur në tërësi borxhin.

Andaj, borxhi i kërkuar sipas propozimit për përmbarim është përmbushur në tërësi, pasi që debitori ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit të përmbarimit, gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 të LPP-së, në të cilin parashihet se *“Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore”*, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm

CP.nr.1108/2021 më datë 21.02.2024

Gjyqtari

Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditorë nga dita e pranimit te të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Mitrovicë.